

V E N D I M
Nr.482, datë 14.10.1999

**PËR NJË PLOTËSIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.747, DATË
26.11.1998 “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SUPERSTRADËS DURRES-SUKTH
PJESË E SUPERSTRADËS TIRANË-DURRES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.7848, datë 25.7.1994 “Për shpronësimin për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në listën emërore, bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave nr.747, datë 26.11.1998, të pronarëve të shpronësuar, të shtohet lista emërore bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të përballohet nga fondi i miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.747, datë 26.11.1998.
 3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i rrethit Durrës, Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

**LISTA EMËRORE E PERSONAVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I
SUPERSTRADËS VORË-DURRES LLOJI I PASURISË SË PALUAJTSHME: TOKË
BUJQËSORE DHE KULTURAT PÛRKATËSE NR.(1-4)**

VENDOS TABELËN